

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nufi: Industria e mbrojtjes, prioritet strategjik për Shqipërinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/nufi-industria-e-mbrojtjes-prioritet-strategjik-per-shqiperine-i585781
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 10:46:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	64c29c14fc4b9e5870e1c5d02f2cffcc38047040d31e1e267acbeec5fa45c8ec
TEKSTI	569cfd111edab289412bc368e0a19a3e10ed35495edc30e45278505af8e01dbc
PAMJA	d16ee5773c2e3c36b33225b8e429de093eec6e9c409360f918e1c2d855fb676d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c657c6ecb4220c300a57b293897a4c3562779e508bfb1d95ad62846d7df386b0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c657c6ecb4220c300a57b293897a4c3562779e508bfb1d95ad62846d7df386b0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e A mund t'i mbijetoje tregu i natës një lufte të përjetshme me Iranin?Elton Llirjani sjell Parashqevi Simakun në New York Fashion Week me një homazh emocionuesObama nëre alarmin për Intelin fundit

Nufi: Industria e mbrojtjes, prioritet strategjik për Shqipërinë

13 Shtator 2026, 14:00PolitikaTEMA



Nufi: Industria e mbrojtjes, prioritet strategjik për Shqipërinë

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi e cilëson zhvillimin e industrisë së mbrojtjes si një prioritet strategjik për Shqipërinë. Përmes një video-mesazhi, ai cilëson se vendi ka hyrë tashmë në një fazë të re, ku industria e mbrojtjes synon të rrisë sigurinë kombëtare, kapacitetet teknologjike dhe zhvillimin ekonomik.

“Zhvillimi i industrisë së mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë dhe çdo hap që lidhet me të, mbetet përherë një lajm i mirë për vendin tonë. Përkundër fantazisë, trillimeve dhe akuzave politike të faktorëve që duan të ushqejnë veten dhe të mbijetojnë në rrugën që kanë humbur, sot asgjë nuk e ndal faktin se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes është një prioritet strategjik për Shqipërinë, prioritet, i cili është në funksion të sigurisë kombëtare, ashtu edhe të angazhimeve tona si një vend anëtar i NATO-s. Shqipëria ka hyrë tashmë në një fazë të re, ku industria e mbrojtjes nuk e sheh më veten si një çështje e vetme sigurie, por si një mundësi strategjike për zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe industrial të vendit”, u shpreh ministri Nufi.

Përmes kompanisë shtetërore KAYO, thotë më tej, Ministri i Mbrojtjes, po zhvillohen aktualisht 6 sipërmarrje të përbashkëta me kompani ndërkombëtare, ndërsa në inventarin e Forcave të Armatosura kanë hyrë 40 mjetet e para të prodhuara në Shqipëri.

“Nëse për shumë vite me radhë, kjo industri u trajtua si një trashëgimi “për t’u shkatërruar”, ne sot po e ndërtojmë dhe fuqizojmë atë me kapacitete drejt së ardhmes. Përmes kompanisë shtetërore KAYO, themeluar në vitin 2024, po ndërtojmë një partneritet me kompani lidere ndërkombëtare. Sot janë në zhvillim gjashtë sipërmarrje të përbashkëta – joint venture, nëpërmjet partneritetit publik-privat, ku KAYO bën pjesë. Në inventarin e Forcave të Armatosura kanë hyrë tashmë 40 mjetet e para të prodhuara dhe shumë shpejt do të fillojmë edhe prodhimin e municionit të lehtë”, theksoi më tej, ministri Nufi.

Ndër të tjera, ai u ndal edhe Fincantieri Albania dhe tek prodhimi i pajisjeve individuale mbrojtëse për Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë.

“Me Fincantieri Albania, falë partneritetit me një lider prestigjioz të prodhimit të anijeve, nuk po blejmë thjesht anije: po fuqizojmë aftësitë shqiptare për të ndërtuar këtu, për të prodhuar për veten dhe për të eksportuar tek vendet e tjera aleate. Pajisjet individuale mbrojtëse, për Forcat e Armatosura dhe institucionet e sigurisë, produkte që deri dje importoheshin, tashmë do të prodhohen në Republikën e Shqipërisë sipas standardit më të lartë ndërkombëtar”, nënvizoi ministri Nufi.

Kjo industri, theksoi Ministri Nufi, nuk duhet të shihet vetëm si një çështje sigurie, por edhe si një mundësi për punësim, teknologji, prodhim vendas dhe zhvillim ekonomik.

“Këto janë vetëm hapat e parë, hapa që pas 17 vitesh si përfituese e sigurisë së Aleancës, Shqipëria po i shndërron gjithnjë e më shumë në hapa konkretë për të qenë kontribuuese e saj faktike. Dhe ky është një fakt që duhet të bëjë krenarë të madh e të vogël; të majtë e të djathtë. Nëse për dekada me radhë, mbrojtja ishte një faturë, sot po ndërtojmë një industri specifike të lidhur me të! Një industri që prodhon siguri, teknologji, kapacitete dhe që gjeneron punësim, edhe këtu në Shqipëri garanton që kemi kapacitetet e duhura për sigurinë e vendit”, përfundon mesazhin e tij, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi.

Lini një Përgjigje

Koment *

[Rama reagon sërish për pagat e magjistratëve: Pavarësia ka rrëshqitur në papërgjegjshmëri, KLP e KLGj të mermin një vendim arbitrar](#)

11:50 Politika / 4 komente

[Rama: Shqipëria drejt marrëveshjes me një rrjet të madh universitar në Londër, në plan hapja e 4 universiteteve të reja](#)

10:40 Politika / 19 komente

[Rezultatet e PISA 2025, Rama: Shqipëria e nisi nga fundi, sot është e para në matematikë](#)

10:20 Politika / 3 komente

[Ngërçi me pagat e magjistratëve, Rama publikon tabelën: Gjyqtarët shqiptarë marrin 500 euro më shumë se kolegët në Greqi, kërkojnë edhe 2000 të tjera](#)

09:50 Politika / 34 komente

[Kosovë/ Vazhdon sot seanca konstituive, pritet zgjedhja e nënkryetarëve dhe zhblokimi i institucioneve](#)

08:52 Politika

[Diskutimet për bashkimin e Vlorës me Selenicën, Rama reagon pas bashkëbisedimit me qytetarët](#)

22:20 Politika / 17 komente

[Protesta përçahet sërish, një grup nis “mosbindjen civile” dhe bllokon Unazën e Vogël](#)

21:57 Politika / 17 komente

[Ballat nga Prishtina: Më 16 shtator drejtësia duhet të shpallë të pafajshëm udhëheqësit e UÇK-së](#)

21:30 Politika / 4 komente

["A do takohesh në Tiranë me ambasadorin amerikan", Berisha ngec: A jam unë amerikan apo shqiptar?!](#)

19:30 Politika / 17 komente

[“Njësitë administrative nuk funksionojnë si duhet”, Rama në Gjirokastër për Reformën Territoriale: Çdo qytet do ketë drejtuesin e tij](#)

19:00 Politika / 5 komente

Më të lexuarat

24 shtet e fundit

Javen e fundit

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog / 60 komente

[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...](#)

15:15 Rajoni / 66 komente

[BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...](#)

14:30 Rajoni / 31 komente

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog / 20 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...](#)

10:02 Politika / 7 komente

Blog Tema

[Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA](#)

12:00 Blog / 2 komente

[EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"](#)

10:30 Blog / 5 komente

[Demokracia jonë pa hardware dhe software?!](#)

08:23 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemaA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemaA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.